



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi		Datë: 14.12.2018	Numri i seancës për këtë çështje: 1
Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut" – projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH).			
<b>A. Informacioni bazë</b>			
Institucioni dhe tema	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, seanca dëgjimore e subjektit të rivlerësimit		
Emri i subjektit të rivlerësimit	Fatos Qato		
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	Gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë. Ky subjekt i nënshtrohet vlerësimit me përparësi për shkak të ish-kandidimit të tij në KED.		
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	Seanca u shty për dhënien e vendimit për në datë 17 Dhjetor, ora 09:00, dhe trupi gjykues nuk paraqiti asnjë arsye për këtë shtyrje.		
lutem paraqisni arsyet në mënyrë të përmblodhur)	Vendimi nuk u shpall në përfundim të seancës dëgjimore, në kundërshtim me nenin 55 pika 6 të ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve".		
<b>B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca</b>			
Trupi gjykues (emrat)	Valbona Sanxhaktari, kryesuese, Suela Zhegu, relatores, dhe Brunilda Bekteshi, anëtare.		
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	Z. Hans Kilstrina		
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	Me avokat, Z. Julian Mërtiri		
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	12 anëtarë nga publiku. Seanca u monitorua edhe nga një vëzhgues i Avokatit të Popullit.		
Media e pranishme:	Në sallën ku u zhvillua seanca dëgjimore u vu re një numër i vogël i përfaqësuesve të medias. Kështu, seanca u monitorua nga përfaqësues të medias së shkruar, (BIRN, dhe Gazeta Shekulli) dhe u vërejt vetëm një operator i medias që të kryente video regjistrimin e çeljes së seancës dëgjimore.		
<b>C. A vendosi institucioni i vettingut ta bëjë vettingun për të tre kriteret apo bazuar vetëm në një apo dy prej tyre?</b>	<b>Po</b>	<b>Nese po, si u justifikua ai?</b>	<b>Nese po, si ka reaguar subjekti ndaj kesaj ?</b>
	Rivlerësimi i këtij subjekti u krye <u>vetëm</u> në bazën e kriterit të pasurisë.	KPK nuk dha justifikime.	
<b>D. Përmbajtja e çështjes (Vlerësimi i kriterëve)</b>	<b>Argumenti</b>	<b>Kush e ka dhënë argumentin</b>	<b>A u diskutua? Prova? A u kalua barra e provës ?</b>
	Në lidhje me këto kriter, raportja e çështjes paraqiti rezultatet e vlerësimit të institucionit ndihmes, ILDKPKI, i cili ka konstatuar pozitivisht lidhur me deklarin dhe ligjshmërinë e të ardhurave që justifikojnë pasuritë e subjektit, si dhe mungesën e situatës së konfliktit të interesit.	ILDKPKI	

D1. Pasuria	<p>Në përfundim të hetimit të saj KPK ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit disponon pasuritë si më poshtë:</p> <p><u>1. Apartament 141 m2 në Tiranë.</u> Lidhur me këtë pasuri KPK ngriti pikëpyetje lidhur me burimin e të ardhurave për blerjen e saj, nisur nga deklaramë kontradiktore të subjektit, fillimisht pagat dhe kursimet familjare, dhe më pas duke shtuar burime nga qiraja e një vile të prindërve të bashkëshortes. KPK gjithashtu mbeti e paqartë në lidhje me pagesën e të 4 kësteve për blerjen e kësaj prone, nga ana e subjektit.</p> <p><u>2. Shtëpi banimi dykatëshe me sip truall 167 m2.</u> KPK e ka konsideruar këtë pasuri pa probleme pasi është konfirmuar se ajo është fituar nga subjekti dhe bashkëshortja e tij me kontratë dhurimi në vitin 2005 nga prindërit e kësaj të fundit.</p> <p><u>3. Depozitë bankare 7,175 Euro</u> në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.</p> <p><u>4. Automjet "Volkswagen Polo",</u> e blerë me çmimin 28,500 Euro me kredi për periudhën 2012 deri në 2017, e cila e ka konfirmuar kredinë e marrë nga subjekti i rivlerësimit.</p> <p><u>5. Tokë arë në fshatin Lin të Pogradecit</u> blerë në vitin 2012 me vlerë 108,00 Lekë. Pasuria është konstatua pa probleme dhe e mbuluar nga të ardhurat e ligjshme dhe çmimi i deklaruar nga subjekti është në përputhje me aktin nënligjor përkatës që përcakton çmimin e tokës.</p> <p><b>Si përfundim, KPK</b> konkludoi se pasuria dhe shpenzimet e subjektit rezultojnë në <b>pambuluar me burime të ligjshme</b>, bazuar në analizën financiare e cila rezultoi me bilanc negativ për 5 vite. Kjo edhe për shkak të shpenzimeve, një pjesë e të cilave të padeklaruara përfshirë shpenzime për mjekim jashtë vendit, në shumën 6500 Euro, shpenzime për shkollimin e vajzës jashtë vendit, si dhe shpenzime për shkollimin e djalit në kolegjin privat në Tiranë.</p> <p>Shpenzimet e deklaruara, kryesisht ato për arredimin e shtëpisë, në vlerën 25000 Euro, ato u paraqitën me deklarata kontradiktore, pasi fillimisht subjekti kishte deklaruar se kjo shumë ishte totali i shpenzimeve për arredim për 5 vitet e fundit, ndërsa në seancë ai deklaroi se kjo shumë përfshinte dhe shpenzimet jetike.</p> <p>Lidhur me të ardhurat nga prindërit e bashkëshortes, KPK nuk u shpreh e bindur lidhur me to në mungesë të deklarimit të tyre në deklaratat periodike apo të dhënave bankare.</p>	Relatori	Barra e provës u kalua sipas ligjit
	<p><u>Në lidhje me apartamentin 141 m2 dhe</u> pagesën e kësteve, avokati i tij u shpreh se subjekti e ka shpjeguar dhe provuar blerjen dhe pagesën e çmimit të kësaj prone me kontratën e porosisë dhe me kontratën e shitjes. Lidhur me mandat pagesën e kësaj të tretë, subjekti nuk e disponon më këtë dokument, por ai e ka konfirmuar se kjo pagesë është kryer. Ndërsa lidhur me këstin e 4rt ai ka qenë vetëm 10 % e vlerës totale, pra 1,820 USD dhe vlerë është zbritur nga vlera totale pasi subjekti ka kryer disa punime vetë në apartamentin në fjalë.</p>	Mbrotjtja	
	<p><u>Lidhur me burimin e të ardhurave</u> për blerjen e apartamentit 141 m2 për blerjen e kësaj pasurie, subjekti deklaroi se të ardhurat për pagesat e kësteve kanë buruar nga puna dhe kursimet familjare (përfshirë të ardhurat nga prindërit e bashkëshortes së tij nga dhënia me qira e vilës së tyre). Ai shtoi se ka bashkëjetuar me prindërit e gruas nga viti 1990 me ekonomi të përbashkët. Ai tha se ata kanë pasur pensione të konsiderueshme, si ish pilot dhe mësuese e gjuhës së huaj dhe se KPK nuk ka marrë në konsideratë të ardhurat e tyre deri në vitin 1997.</p> <p>Ai shtoi se deklarimi periodik nuk i detyronte subjektet të paraqesin të ardhurat e prindërve të bashkëshortit/es.</p> <p>Gjithashtu ai nuk ishte dakord me mënyrën e llogaritjes së çmimit të pasurisë bazuar në kursin e këmbimit të momentit të kryerjes së pagesës, vitit 1997, ku kursi ka qenë shumë i lartë, 151.95, në krahasim me vitet e mëparshme gjatë të cilave ai ka realizuar kursimet.</p> <p><u>Lidhur me shpenzimet për shkollimin e të bijës</u> subjekti deklaroi se ato janë mbuluar nga bashkëjetuesi i vajzës, holandez, dhe për këtë ka paraqitur kontratat e tij të punës. Ndërkohë që KPK nuk u mjaftua me këtë pasi sipas saj kjo provonte se subjekti në fjalë kishte të ardhura por nuk provonte pagesën e shpenzimeve të shkollimit të vajzës së gjyqtarit të apelit.</p> <p><u>Lidhur me shpenzimet për kurimin jashtë vendit dhe ato për shkollimin e fëmijëve</u> ai u shpreh se i ka konsideruar ato si shpenzime jetike dhe i ka deklaruar si pjesë të tyre.</p> <p><u>Lidhur me analizën financiare,</u> subjekti ka paraqitur analizën e vet financiare në të cilën ka shtuar të ardhurat nga prindërit e bashkëshortes së tij pas së cilave bilanci kthehet pozitiv për të gjitha vitet.</p>	Subjekti	

	Asnjë Vëzhguesi i ONM, Hans Kilstrina, e pyeti subjektin në lidhje me qëndrimin e tij përfundimtar sa i takon pagesës së kështit të fundit. Subjekti u përgjigj se ai e ka "likuiduar" shitësin dhe se një pesë nga 10 % i mbetur është zbritur si pasojë e punimeve të kryera prej tij. Ndërkohë që avokati saktësoi se kompensimi është një nga format e pagesës.	Ankesa nga publiku  ONM	
D2. Figura /Kontaktet me krimin e organizuar	Ky kriter nuk u vlerësua	Relatori Mbrojtja Subjekti Ankesa nga publiku ONM	
D3. Vlerësimi i aftësive profesionale dhe etikës	Ky kriter nuk u vlerësua	Relatori Subjekti, etj.. OMN	
E. Konkluzione dhe komente të monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vettingut dhe përfaqësuesit të OMN, si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektit, barazia e mjeteve ligjore, parimi i kontradiktoritetit, koha e arsyeshme, e drejta për të paraqitur prova dhe e drejta për tu dëgjuar, etj.)	<p><b>Parimi i publicitetit të gjyqimit</b> Data, vendi, dhe ora i zhvillimit të seancës dëgjimore u njoftua publikisht në faqen zyrtare të internetit të KPK. Në drejtim të respektimit të parimit të publicitetit të seancës vërehet një zhvillim pozitiv pasi seanca u zhvillua në sallën e Pallatit të Koncerteve, e cila ofron një kubaturë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për pjesëmarrjen e publikut që dëshiron të ndjekë seancat.</p> <p><b>Akresi në mjediset e zhvillimit të seancës dëgjimore</b> Lidhur me aksesin fizik në sallën ku zhvillohej seanca dëgjimore, vërehet mungesë e shenjzimit të dukshëm dhe të përshtatshëm për orientimin e publikut dhe medias. Pas disa vështirësive për të aksesuar sallën, vëzhguesi u pyet se kë përfaqësonte dhe të nënshkruante një listë-prezencë në hyrjen e saj.</p> <p><b>Parimi i proporcionalitetit</b> Neni 52 i Ligjit 84/2016 pika 1 parashikon se " Komisioni dhe Kolegji i Apelit në shqyrtimin e çështjeve udhëhiqen nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit". Në lidhje me peshën e deklaratave periodike vihet re se në këtë rast KPK i jep atyre një vlerë përcaktuese për vërtetësinë e deklaratimeve të subjektit gjatë hetimit të tij. Kështu, Komisioni ka konkluduar se "e vetmja mënyrë për të provuar realizimin e kursimeve është përfshirja e tyre në deklaratat periodike të pasurisë ose dokumente bankare". Vihet re që në raste të tjera, ligji është interpretuar se mjafton deklarimi i subjektit deklarimi i subjektit e shoqëruar me ligjshmërinë e të ardhurave të personave të lidhur për ta konsideruar të ardhurën si të ligjshme dhe për të përmbytur prezumimin e paligjshmërisë së saj. Një zbatim i ndryshëm i standardeve të provueshmërisë së përfundimit të pasurive nga personat e lidhur krijon pabarazi dhe mungesë standardi të njëjtë në zbatimin e ligjit. Kjo vlen edhe për qëndrimin e KPK lidhur me pagesën e kështit të 3 dhe të 4 të apartamentit 141 m2 pasi kjo është vërtetuar nga kontrata e shitjes dhe regjistrimi e pasurisë në ZRRP pra nuk është e qartë dhe duket jo objektive që KPK e konsideron kryerje e kësaj pagesë të paprovuar për shkak se mungojnë mandat pagesat përkatëse.</p>		